



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:120052

Datë: 05.03.2024

Numri i dokumentit: 05663222

C.nr.628/17

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL, gjyqtari Burim Emërllahu ,në çështjen juridike të paditësit H.F. ,nga fshati N....Komuna e Ferizajit ,të cilin në bazë të autorizimit e përfaqësonë avokati Jeton Berisha ,nga Ferizaji ,kundër të paditurit A.K. ,nga Fshati N.... Komuna e Ferizajit,me numër personaltë cilin në bazë të autorizimit e përfaqëson avokati Lavdrim Xheladini,nga Ferizaji, ,nga Ferizaji,baza juridike kthimi dhe dorëzimi i pronës tek pronari,me datë 05.03.2024 ,mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit H.F. nga Fshati N.... Komuna e Ferizajit . Detyrohet i padituri A.K. që paditësit H.F. t'ia lirojë njësin kadastrale ... Zona Kadastrale N... dhe të njejtën tia dorëzoj në posedim paditësit H.F.

II.Detyrohet i padituri A.K. që paditësit H.F. në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore tia paguajë shumat siq vijon:Për 9 seanca gjyqësore shumë prej 1216.80 euro,për përpilimin e padis 104 euro,për ekspertizën e gjeodezisë 75 euro ,të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqieshmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa e të autorizuarit të të paditurit A.K. ,avokatit Lavdrim Xheladini me të cilën i ka kërkuar shpenzimet sipas tarifës së OAK-së.

IV.Detyrohet paditësi H.F. që kësaj gjykate në emër të shtesës së taksës gjyqësore për padi tia paguaj shumë e të hollave prej 40 euro ,në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi H.F. ,nga fshati N.... Komuna e Ferizajit , ka parashtruar padi në këtë gjykatë ,kundër të paditurve A.K. dhe S.Q. ,me bazë juridike kthimi dhe dorëzimi i pronës tek pronari.

Paditësi H.F. në padi në lidhje me qështjen kontestuese ka theksuar: Paditësi është pronar i paluajtshmërive me të dhënat si në vijim: P-....., me sipërfaqe prej 2321 m/2, në vendin e quajtur "...", me kulturë Bujqësore, Arë e klasit të 5 ZK N...: P-....., me sipërfaqe prej 2156 m/2 në vendin e quajtur "...", me kulturë Bujqësore, arë e klasit të 5 ZK N...: P-..... me sipërfaqe prej 2156 m/2 në vendin e quajtur "...", me kulturë bujqësore, të 3 ZK N., P-.....1 me sipërfaqe prej 1034 m/2, në vendin e quajtur "...", me kulturë Bujqësore, arë e klasit të 5 ZK N..... dhe P-....-0 me sipërfaqe prej 914 m/2 në vendin e quajtur "P...j" me kulturë bujqësore, arë e klasit të 4 ZK N....., të cilat njësi i ka në pronësi sipas Kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmërisë së datës 11.12.2009, e vërtetuar pranë Gjykatës Komonale në Ferizaj, me nr. të protokollit .../09. Duke qenë se paditësi jetonte në Gj..... pronat kontestuese i punonin dhe shfrytëzonin për qëllime bujqësore vëllezërit dhe nipi i tij – të paditurit. Pas pensionimit të paditësit në shtetin e Gj.... ai kishte vendosur të kthehet në Kosovë dhe rrjedhimisht edhe pronat e tij t'i punojë dhe të kujdeset për to vetë paditësi. Për këtë qëllim kishte kërkuar nga të paditurit verbalisht që këto prona ti lirojnë dhe të mos i punojnë më, nga se të njëjtat do ti punoj vetë, mirëpo edhe për kundër kërkesës së paditësit që pronat e tij të lirohen, të paditurit nuk ia kishin liruar dhe kishin vazhduar ti punojnë kundër vullnetit të paditësit. Duke pasur për bazë raportet familjare mes ndërgjyqësve dhe me qëllimin që të mos vie deri te mosmarrëveshjet ndërmjet tyre apo ndonjë konflikt paditësi iu kishte ofruar të paditurve që këto prona t'ua shes por ofertën e tij të paditurit, nuk e kishin pranuar dhe kishin vazhduar që pronat kontestuese t'i shfrytëzonin.

Përfaqësuesi i paditësit avokati Jeton Berisha, nga Ferizaji në lidhje me qështjen kontestuese ka theksuar: paditësi përmes padisë kishte kërkuar nga gjykata që të detyrohen të paditurit A.F., S.Q. dhe F.F. nga fshati N.... Komuna e Ferizajit, që paditësit t'ia lirojnë pronën dhe atë: i padituri A.K. detyrohet ta liroj njësinë kadastrale ... ZK Ne... i padituri S.Q. detyrohet t'ia liroj njësitë kadastrale dhe ... ZK N... i padituri F.F. detyrohet t'ia liroj njësitë kadastrale ... dhe ... ZK N., dhe të njëjtat t'ia dorëzojnë në posedim paditësit si pronar legjitim i tyre. Për ta dëshmuar faktin se paditësi është pronar juridik i paluajtshmërisë së bashku me padinë gjykatës ia kishte prezentuar edhe certifikata e pronës, me nr..... me datë 23.04.2014 dhe Kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë me nr. ... e lidhur me datë 11.12.2009. Të paditurit A.F., S.Q. e kanë kundërshtuar padinë, me arsyetimin se prona kontestuese nuk është e paditësit, se këtë pronë nuk e kishte blerë paditësi por është pronë që e kishin në posedim nga para ardhësit, e tyre, se kinse paditësi e kishte vënë në lajthim paraardhësi juridik F.R.. I padituri F.F. në momentin që nga gjykata i është dorëzuar padia për përgjegjje në padi, e kishte kontaktuar paditësin dhe të njëjtit ia kishte liruar pronën më saktësisht njësitë kadastrale ... dhe ... ZK N., ndërsa të paditurit A.F., S.Q. kanë kundërshtuar lirimin e pronës. Gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetuan këto fakte: Se pronat kontestuese paditësi H.F. i kishte blerë në vitin 19... me çmim kontraktues prej 17,500 DM. Ky fakt është vërtetuar përmes Kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmërisë të datës 11.12.2009 e vërtetuar në Gjykatën Komonale në Ferizaj me nr. VR.nr... dhe përmes dëgjimit të dëshmitarit F.R., i cili ka deklaruar se kontratën

e shitblerjes së paluajtshmërisë e kishte nënshkruar vullnetarisht dhe pronën ia kishte bartë paditësit. Vlen të theksohet se ky dëshmitar F.R. e ka mohuar se ishte vë në lajthim nga paditësi H.F., nga se të njëjtit vullnetarisht ia kishte bartur pronën. Pra nga kjo deklaratë konfirmohet se deklarimi i të paditurve se kinse paditësi e kishte vënë në lajthim para ardhësin juridik F.R. ishte e pa qëndrueshme. Faktin se paditësi nga data 11.12.2009 prona kontestuese i ka të regjistruar në regjistrat kadastral në KK Ferizaj në emrin e tij. Ky fakt është vërtetuar përmes aktvendimit me nr. të datës 17.12.2009 dhe çertifiakta e pronës me nr. por edhe përmes ekspertizës gjeodezike të përpiluar nga eksperti M.M.Sipas këtyre provave është rikonfirmuar se pronar juridik i kësaj paluajtshmërie i regjistruar në regjistrat kadastral nga data 11.12.2009 është paditësi H.F. Faktin se deri në ditën e ushtrimit të padisë përkatësisht deri në ditën e sotme, prona i kanë në posedim paditësit, ishte fakt jo kontestuese, pra nuk është kundërshtuar as nga të paditurit dhe as nga paditësi. Baza juridike: Për sa i përket shitblerjes së paluajtshmërive, dispozita e nenit 36 par. 1 LPDTS përcakton se: “Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri.” Në kuptim të kësaj dispozite ligjore Kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë të datës 11.12.2009 e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Ferizaj, me nr. VR.nr.7097, e nënshkruar ndërmjet paditësit si blerë dhe F.R. si shitës është bazë e vetme juridike për vërtetimin e të drejtës së pronësisë në këtë njësi kadastrale. Për sa i përket posedimit të pronësisë dhe regjistrimit të saj në regjistrat kadastral, dispozita e nenit 40 par. 2 të LPDTS përcakton se: “Personi i cili ka dhjet (10) në posedim të pandërprerë një paluajtshmëri dhe nëse ai është regjistruar si posedues pronësor në Kadastër e fiton pronësinë në paluajtshmërinë ose në ndonjë pjesë të saj, në qoftë se brenda këtij afati nuk është regjistruar ndonjë kundërshtim lidhur me regjistrimin”. Edhe kjo dispozitë është bazë për vërtetimin e të drejtës së pronësisë në njësinë kadastrale kontestuese. Për sa i përket të drejtës së shfrytëzimit dhe lirit të pronës dispozita nenit 94, 97, 98 e në vazhdim të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDTS), kanë përcaktuar në mënyrë të qartë se prona duhet të lirohet dhe të drejtën e shfrytëzimit e mbanë vetëm paditësi. Përmes një aktgjykimi eventual me të cilën do të aprovohej kërkesë padia e paditësit, gjykata do të ndikonte në ngritjen e besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë duke marrë para sysh faktin se mbrojtja e pronës është e mbrojtur me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht me nenin 46 të saj .

Përfaqësuesi i të paditurit A.K. av. Lavdrim Xheladini në lidhje me qështjen kontestuese ka theksuar: e kundërshtoj kërkesë padinë e paditësit, si të pa bazuar, dhe të pa mbështetur në prova dhe theksoj se nga ushtrimi i provave konkretisht nga dëgjimi i dëshmitarit F.R., u vërtetua fakti se paditësi nuk është posedues. Si pronar juridik, paditësi ishte i regjistruar me keq besim duke e shfrytëzuar pozitën e F.R., si pronar fiktiv i cili në seancën e datës 22.01.2020 deklaroi, se nuk ishte pronar i asaj paluajtshmërie, andaj kuptohet se i njëjti nuk mund të bartë qfarëdo të drejta pronësore për atë paluajtshmëri dhe konsiderojmë

se gjykata për nulitetin e asaj kontrate duhet të përkujdeset sipas detyres zyrtare, nga lartë cekurat, i propozojmë gjykatës që kërkesë padinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar, dhe i kërkojmë shpenzimet e përfaqësimit sipas tarifës së OAK-së.

Përfaqësuesja e të paditurit S.Q. avokatja Zejnepe Zenuni, nga Ferizaji kishte theksuar: Nga provat e administruara në seancat gjyqësore të zhvilluara gjatë këtij procesi gjyqësor siq janë: dalja e gjykatës në vendin e paluajtshmërisë si dhe dëgjimi i dëshmitarëve e posaqerisht A.Q. të dhënë në seancën e datës 2 shtator 2019 i cili dëshmoi për faktin e posedimit të paluajtshmërive kontestuese dhe ate mjaft bindshëm se i padituri i dytë i ka në posedim paluajtshmëritë të cilat pretendon paditësi se janë pronat e tij, si dhe faktin se paditësi nuk i ka pasur asnjë herë në posedim këto ngastra . Dëshmitari më relevant në këtë çështje F.R. në seancën e datës 22 janar 2020, dëshmoi bindshëm se këto paluajtshmëri asnjë herë nuk i ka blerë paditësi nga dëshmitari i cili është nënshkruer i kontratës të cilën e përdor paditësi si provë në lidhje me këto ngastra dhe u vërtetua bindshëm deklarimi i të paditurve se këto prona janë blerë nga para ardhësi i tyre – babai M.Q., tani i ndjerë. Kështu që kontata me të cilën paditësi i ka bartur ngastrat kontestuese në emrin e tij u dëshmuar se është kontratë fiktive dhe se paditësi e ka keqpërdorur dëshmitarin F.R. duke e vu në lajthim për kinse këto prona janë të tijat. Me daljen në vendin e paluajtshmërisë konsideroj se u vërtetua shumë qartë se paluajtshmëritë me numër ... dhe ZK N...., kanë qenë dhe janë në posedim të të paditurit të dytë S.Q., gjë që ky fakt nuk u kontestua as nga paditësit i cili u deklarua se anjë herë nu i ka pasur në posedim. Nga deklaratat e dëshmitarëve dhe nga deklaratat e të paditurit të dytë u dëshmuar dhe u vërtetua fakti se babai i palëve ndërgjyqjese e kishte blerë paluajtshmërinë lëndore, mirëpo për shkaqe të realizimit të shtesave feminare për kohën kur ka qenë në jetë këto ngastra i ka bartur në emrin e familjares së tyre T.R.. Sipas nenit 4 të LPDS i cili parashef prezumimin e mirëbesimit i padituri në këtë çështje kontestimore nuk ka arritur ta rrëzoj prezumimin sepse nuk ka ofruar as të vetmen provë me të cilën do të dëshmonte se si prona kontestuese është blerë nga ai dhe as të vetmen arsye për mos marrjen në posedim të kësaj ngastre dhe asnjë provë që në këtë ngastër ka qenë në posedim as për vetëm një ditë të vetme. Paditësi nuk arriti të rrëzoj deklaratimet e të paditurve se këto ngastra i kanë fituar në bazë marrveshjes ndër familjare për ndarjen e pasurisë së përbashkët familjare si trashëgimtar të M.Q., dhe që këto ngastra i kanë takuar të paditurit të dytë ndërsa paditësi ka marrur ngastra të tjera dhe atë shumë ma me vlerë të paluajtshmëritë kontestuese. Andaj paditësi nuk ka kurrfarë mbështetje ligjore për të kërkuar lirimin e ngastrave objekt kontesti sepse asnjë herë nuk ka qenë të tij dhe asnjë herë nuk ka qenë në posedim faktik që këto ngastra evidentohen në emrin e tij nuk nënkupton se i njëjti e ka fituar edhe të drejtën e pronësisë për të kërkuar lirimin e tyre nga i padituri i dytë. Andaj gjykatës i propozojmë që, padinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar dhe ta obligoj paditësin që të ia kompensoj të paditurit të dytë S.Q. shpenzimet e procedurës dhe atë: për përfaqësim të avokatit për 6 seanca sipas tarifës së OAK-ës në shumë prej 270 euro për çdo seanc dhe për përgjigje në padi shumë prej 201 euro, që gjithësejt shuma totale është 1821€.

Me qëllim të vërtetimit sa më të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë qështje civile juriidike janë administruar si provë: kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë, e datës 11.12.2009, e lidhur në mes të F.R. në cilësi të shitësit dhe H.F., në cilësi të blerësit, certifikata pronësore e dt. 23.04.2014, me numër 31586 e lëshuar nga ZKK Ferizaj, kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë e pa vërtetuar në gjykatë e dt. 24.10.1997, kontrata mbi faljen e paluajtshmërisë e lidhur në mes M.Q., si dhuratë dhënës dhe A.F. dhuratë marrës me numër 231/05 e dt. 21.01.2005, shkresa e emërtuar si kontratë , më dt. 03.03.1963, aktvendimi për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore të të ndjeres T.R., ish nga fshati V....me numër T.nr. 195/88 i dt. 26.07.1989, shiqimi në dy foto ku shkruan pika grumbulluese e grurit ,Kosova, dhe shënime tjera. historiat i dt. 05.06.2014 me numër ... i lëshuar nga ZKK Ferizaj, shkresa me numër 158 ku shënon emri H.F. dt. 19.07.2009, shkresa me dt. 31.05.1992, skicat e identifikimit me matje, - mendimi dhe konstatimi i ekspertit gjeodet Memet Memeti, për ngastrat kontestuese, së bashku me dokumentet përcjellëse.certifikatat pronësore - tri certifikata pronësore të dt. 02.04.2019, për paluajtshmëritë kontestuese janë dëgjuar në cilësi të palëve H.F.,I padituri A.F. ,i padituri S.Q.,si dhe janë dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve:dëshmitari F.F. ,nga Fshati N.... Komuna e Ferizajit, dëshmitari H.Q.nga Fshati N... Komuna e Ferizajit,dëshmitari A.Q. ,nga Fshati N...Komuna e Ferizajit,F.R. ,nga Fshati V.... Komuna e Ferizajit.

Gjykata provat e administruara i ka vlerësuar sipas nenit 8 të LPK-së dhe ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Me leximin e Kontratës mbi Shitblerjen e Paluajtshmërisë, e datës 11.12.2009,e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Ferizaj me nr. Vr.nr.... e lidhur në mes të F.R. nga Fshati V...Komuna e Ferizajit , në cilësi të shitësit dhe H.F.,nga Fshati N.... në cilësi të blerësit,gjykata ka vërtetuar se me date 11.12.2009 Florim Rexha në cilësi të shitësit ia ka shitur ngastrat kadastrale kontestuese të cekura në dispozitiv të këtij aktgjykimi paditësit H.F. në cilësi të blerësit ,për qmimin e shitblerjes prej 8500 euro.Kurse me rastin e lidhje së kësaj kontrate shitësi F.R. kishte deklaruar për paluejtshmërit e shitura se gjyshja e tij ka marrë pjesën e vet të trashëgimis prej paraardhësit të blerësit,e pas shfrytëzimit një kohë të shkurt në vitin 1969 ia ka shitur blerësit për qmimin prej 17500 DM.Shitësi I kishte garantuar blerësit se pasuria e paluejtshme e shitur është pasuri e tij dhe se në të askush nuk ka të drejtën e pronësisë dhe se e njejta paluejtshme nuk është e ngarkuar me asnjë barrë juridike.Shitësi kishte deklaruar se blerësi në tërësi e ka përmbush obligimin kontraktues ndaj tij,si dhe i njejti ia kishte lejuar blerësit që pas legalizimit të kësaj kontrate në gjykatë paluejtshmërit e blera ti regjistroj në emër të blerësit në librat e tokës në Drejorin për Kadastër Gjeodezi dhe Pronësi të KK Ferizaj.

Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit gjeodet M.M. për ngastrat kontestuese, së bashku me dokumentet përcjellëse ,gjykata ka vërtetuar se ngastra kontestuese 301-0 ZK N... Komuna e Ferizajit në regjistrin kadastral evidentohet në emër të paditësit H.F. ,nga prindi M....Gjendja faktike e ngastres kadastrale 301-0 është se nuk ka pasur të mbjedhur asgjë ,për monentin kishte mbirë bari natyral dhe një pjesë e lavruar.Ngastra kadastrale 301-0 ka qenë në emër të Rexhovit T....[e lindur Q.B.V...]dhe në vitin 1989 me aktvendim të trashëgimis T.nr.195/88 ,të Gjykatës Komunale të datës 26.07.1989 ka kaluar në emër të I.R.,nga babai V....,kurse në bazë të aktvendimit mbi trashëgimin T.nr..... ,të datës 03.12.2009 të Gjykatës

Komunale ka kaluar nga I.R. në emër të F.R. ,kurse në bazë të kontratës për shitblerjen e paluejtshmërisë Vr.nr.7097/2009 ,të datës 11.12.2009 ka kaluar në emër të H.F.

Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit gjeodet M/M. për ngastrat kontestuese, së bashku me dokumentet përcjellëse ,gjkata ka vërtetuar se ngastra kontestuese ... ZK N. Komuna e Ferizajit në regjistrin kadastral evidentohet në emër të paditësit H.F. ,nga prindi M..Gjendja faktike e ngastres kadastrale 327-0 është se nuk ka pasur të mbjedhur dhe ka pasur disa talla nëpër ar dhe ka qenë e lavruar në dy skajet e arës nga 3 m gjerësi dhe 69.70 m gjatësi .Ngastra kadastrale 327-0 ka qenë në emër të R.T. [e lindur Q.B.V.dhe në vitin 1989 me aktvendim të trashëgimis T.nr.195/88 ,të Gjykatës Komunale të datës 26.07.1989 ka kaluar në emër të I.R.,nga babai V.,kurse në bazë të aktvendimit mbi trashëgimin T.nr.... ,të datës 03.12.2009 të Gjykatës Komunale ka kaluar nga I.R. në emër të F.R. ,kurse në bazë të kontratës për shitblerjen e paluejtshmërisë Vr.nr.... ,të datës 11.12.2009 ka kaluar në emër të H.F.

Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit gjeodet M.M. për ngastrat kontestuese, së bashku me dokumentet përcjellëse ,gjkata ka vërtetuar se ngastra kontestuese ... ZK N. Komuna e Ferizajit në regjistrin kadastral evidentohet në emër të paditësit H.F. ,nga prindi M.Gjendja faktike e ngastres kadastrale ... është e mbjedhur me bari natyral .Ngastra kadastrale 328-0 ka qenë në emër të R.T. [e lindur Q.. B.V...]dhe në vitin 1989 me aktvendim të trashëgimis T.nr.... ,të Gjykatës Komunale të datës 26.07.1989 ka kaluar në emër të I.R.,nga babai V. kurse në bazë të aktvendimit mbi trashëgimin T.nr.... ,të datës 03.12.2009 të Gjykatës Komunale ka kaluar nga I.R. në emër të F.R. ,kurse në bazë të kontratës për shitblerjen e paluejtshmërisë Vr.nr.... ,të datës 11.12.2009 ka kaluar në emër të H.F.

Me leximin e kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmërisë e pa vërtetuar në gjykatë e dt. ... gjykata ka vërtetuar se me datë 24.10.1997 ishte lidhur kontrata në fjalë në mes të M.S.Q. dhe K.M.Q.F. si blerës dhe M.V.R. si shitës.Në të cilën kontratë palët në fjalë kishin theksuar se para 30 vjetësh e kanë kryer shitblerjen e kësaj paluejtshmërije –parcelat ..., ..., ..., ..., ..., ..., Komuna Kadastrale N.... .Kontraktuesit e kanë kryer shitblerjen para 30 vjetësh dhe blerësit ja kanë dhënë në tërësi shumën e të hollave në vlerë të 50.000[pesëdhjetë mijë DM],të cilat blerësit e paluejtshmërisë jav kanë dorëzuar shitësve të paluejtshmëris në tërësi.Paluejtshmerin e cekur në pikën një të kësaj kontrate shitësit jav dorëzojnë blerësve pa kurrfarë barre juridike në të mirë të paluejtshmerive tjera .Kontraktuesit nuk e kanë kryer mbartjen e kësaj paluejtshmerie meqë shitësi M.R. ka jetuar në Australi.Blerësit e Paluejtshmerisë së cekur në pikën I të kësaj kontrate kanë hyrë në posedim dhe shfrytëzim të paluejtshmerisë nga dita e blerjes dhe e shfrytëzojnë pa kurrfarë pengese nga të tjerët.

Gjykata pjesës së kontratës në fjalë ku theksohet si shitës edhe V.A.R. nuk ia fali besimin ,sepse nga e njejta kontratë rezulton se V.A.R. nuk ka nënshkrim në të njejtën.

Sipas qëndrimit të kësaj gjykate e njejta kontratë nuk prodhon efekt juridik sepse nuk është lidhur në gjykatë dhe në kohën e lidhjes së sajë M.V.R. nuk ka qenë pronarë i së njejtës

paluejtshmëri ,kjo edhe për shkak se e njejta paluejtshmëri në vitin 1997 ka qenë e evidentuar në regjistrin kadastrale në emër të I.R.,nga babai V.

E po ashtu edhe deklaratave të theksuara nga palët në atë kontratë gjykata nuk ua fali besimin ,sepse paluajtshmëria kontestuese në vitin 1997 nuk ka qenë në emër të palëve në fjalë.

Gjykata ka analizuar kontratë mbi faljen e paluajtshmërisë e lidhur në mes M.Q.si dhuratë dhënës dhe A.F. dhuratë marrës me numër 231/05 e dt. 21.01.2005 ,por sipas qëndrimit të kësaj gjykate e njejta kontratë nuk mund të ketë ndikim në këtë qështje ,sepse nuk ka të bëjë me paluejtshmërinë kontestuese.

Gjykata ka analizuar edhe shkresën e emërtuar si kontratë , më dt. 03.03.1963,miërëpo sipas qëndrimit të kësaj gjykate e njejtat nuk mund të ketë ndikim në këtë qështje ,sepse nuk mund të kuptohet se për cilën ngastër është fjala ,sepse në të njejtën nuk përmendet ndonjë ngastër kadastrale.

Gjykata ka analizuar edhe dy foto ku shkruan pika grumbulluese e grurit ,Kosova, dhe shënime tjera por sipas qëndrimit të kësaj gjykate të njejtat nuk mund të kenë ndikim në këtë qështje ,sepse të njejtat nuk vërtetojnë ndonjë fakt vendimtar ,sepse nuk përmendet ndonjë numër i ngastrës kadastrale në të njejtat.

Gjykata ka analizuar edhe shkresa me numër 158 ku shënon emri H.F., dt. 19.07.2009,por e njejta shkres nuk mund të ketë ndikim në këtë qështje,sepse nuk theksohet ndonjë numër ngastre ,por vetëm theksohet se H.F. dorëzoi grurë 294 Kg ,pranoi A.

Gjykata ka analizuar edhe shkresn e dt. 31.05.1992,por sipas qëndrimit të kësaj gjykate e njejta shkresë nuk mund të ketë ndikim në këtë qështje ,sepse nuk dihet se për cilat ngastra është fjala, sepse në të njejtën nuk theksohet ndonjë numër i ndonjë ngastre kadastrale.

Gjykata ka analizuar deklaratën e dëshmitarit F.F. ,por me të njejtën deklaratë nuk vërtetohen faktet vendimtare sepse i njejtë dëshmitar thekson se nuk din gjë për shitblerje të tokës kontestuese ,sepse ka qenë i vogël.

Gjykata ka analizuar deklaratën e dëshmitarit H.Q. por me të njejtën deklaratë nuk vërtetohen faktet vendimtare sepse i njejtë dëshmitar thekson se nuk din asgjë për paluejtshmërit kontestuese dhe as nuk di ku janë.

Me dëgjimin e dëshmitarit A.Q. gjykata ka vërtetuar se tokën kontestuese e ka punuar mixha i tij M.Q. baba i tani palëve ndërgjyqëse .Tokën kontestuese e ka punuar edhe A. pas luftes .Po ashtu edhe S.e ka shfrytëzuar tokën kontestuese pas luftes .Tokat kontestuese për momentin i punojnë A.dhe S.

Theksimit të dëshmitarit A.Q. se tokën kontestuese e ka blerë M.Q. gjykata nuk ia fali besimin edhe atë nga këto arsye: I njejtë dëshmitar nuk thekson kohën kur është blerë ajo tokë, vitin kur është blerë ,sa para është blerë ajo tokë ,kush ka qenë prezent kur është blerë,nga kush është blerë ,si dhe në këtë drejtim nuk është prezantuar ndonjë provë shkresore e lidhur në mes të pronarit të paluejtshmërisë si shitës dhe M.Q. si blerës, dhe nuk ka dëshmuar ndonjë dëshmitar që ka qenë prezent me rastin e shitblerjes së pretenduar nga dëshmitari.Përveq kësaj nga vet deklarata e këtij dëshmitari rezulton se nuk ka qenë prezent në lidhje me faktin e theksuar ,sepse i njejtë thekson se ka ndëgjuar nga babai tij,kurse babai tij nuk ka qenë dëshmitar që tu mundësohet palëve dhe gjykatës për të vërtetuar saktësin e deklaratës së tij,përmes dëgjimit.

Gjykata nuk ia ka falur besimin deklaratës së të paditurit A.K. me të cillën ka theksuar se tokën kontestuese e ka blerë babai i tij edhe atë nga këto arsye:,nga vet deklarata e të njejtë rezulton se nuk ka qenë prezentë në lidhje me faktin e theksuar ,por thekson se ka dëgjuar nga babai tij dhe K. vllau i madh ,kurse gjykatës dhe palëve nuk u është mundësuar ta vërtetojnë saktësin deklaratës së babait të dëshmitarit dhe K. përmes marrjes në pyetje ,i njejtë nuk thekson sa para është blerë toka në fjalë,në këtë drejtim nuk është prezantuar ndonjë provë shkresore e lidhur në mes të pronarit të paluejtshmërisë si shitës dhe M. si blerës dhe nuk ka dëshmuar ndonjë dëshmitar që ka qenë prezent me rastin e shitblerjes së pretenduar nga i padituri A.F.

Gjykata nuk ia ka falur besimin deklaratës së të paditurit A.K. kur ka theksuar se me rastin e ndarjes së vëllëzërve në vitin .. ngastra kadastrale nr.... i ka ra të njejtë ,kurse tokat që po kërkohen nga paditësi prej S.Q. i kan ra S.Q. dhe H.F. ,kurse arsyet që gjykata nuk ia ka falur besimin deklaratës në fjalë janë :fakti i theksuar nga A.F. nuk vërtetohet me deklaratën e ndonjë dëshmitari prezent ,i njejtë fakt nuk provohet me ndonjë provë shkresore të vlefshme në aspektin juridik.

Gjykata nuk ia ka falur besimin deklaratës së të paditurit A.K. kur ka theksuar se babai ngastren kontestuese ma ka falur ,kurse arsyet që gjykata nuk ia ka falur besimin deklaratës në fjalë janë: fakti i theksuar nga A.K. nuk vërtetohet me deklaratën e ndonjë dëshmitari prezent ,i njejtë fakt nuk provohet me ndonjë provë shkresore të vlefshme në aspektin juridik.

Gjykata nuk ia ka falur besimin deklaratës së të paditurit A.K. i cili paluejtshmerin kontestuese e quan pronë të tij,sepse një fakt i tillë nuk vërtetohet me dëshmi të lëshuar nga regjistri kadastral.

Nga deklarata e të paditurit A.K. gjykata ka vërtetuar se ai është në posedim të ngastrës kontestuese ... ,së cilës deklaratë gjykata ia fali besimin ,sepse përputhet edhe me deklaratën e dëshmitarit A.Q. si i përket posedimit ,si dhe vet paditësi në deklaratën e tij në

cilësi të palës dhe pjesërishtë në padi ka theksuar se tokën kontestuese e ka shfrytëzuar familja M. ,babai im dhe vëllëzërit e mi e që vëllëzërit e paditësit janë edhe të të paditurit.

Gjykata nuk ia ka falur besimin deklaratës së të paditurit S.Q. me të cillën ka theksuar se tokën kontestuese e ka blerë babai i tij edhe atë nga këto arsye:,nga vet deklaratat e të njejtit rezulton se nuk ka qenë prezentë në lidhje me faktin e theksuar ,por thekson se ka dëgjuar nga babai i tij ,kurse gjykatës dhe palëve nuk u është mundësuar ta vërtetojnë saktësin deklaratës së babait të dëshmitarit përmes marrjes në pyetje ,i njejtë nuk thekson sa para është blerë toka në fjalë,në këtë drejtim nuk është prezantuar ndonjë provë shkresore e lidhur në mes të pronarit të paluejtshmërisë si shitës dhe M... si blerës dhe nuk ka dëshmuar ndonjë dëshmitar që ka qenë prezent me rastin e shitblerjes së pretenduar nga i padituri S.Q.

Gjykata nuk ia ka falur besimin deklaratës së të paditurit S.Q. kur ka theksuar se me rastin e ndarjes së vëllëzërve në vitin 1992 ngastrat kadastrale nr.... i ka ra A.K. ,kurse ngastrat 327 dhe 328 i kanë ra S.Q. dhe H., me këtë ndarje është pajtuar paditësi ,kurse arsyet që gjykata nuk ia ka falur besimin deklaratës në fjalë janë :fakti i theksuar nga S.Q. nuk vërtetohet me deklaratën e ndonjë dëshmitari prezent ,i njejtë fakt nuk provohet me ndonjë provë shkresore të vlefshme në aspektin juridik.

Nga deklaratat e të paditurit S.Q. gjykata ka vërtetuar se ai është në posedim të ngastrave kontestuese 327 dhe 328 ,së cilës deklaratë gjykata ia fali besimin ,sepse përputhet edhe me deklaratën e dëshmitarit A.Q. si i përket posedimit ,si dhe vet paditësi në deklaratën e tij në cilësi të palës dhe pjesërishtë në padi ka theksuar se tokën kontestuese e ka shfrytëzuar familja M. babai im dhe vëllëzërit e mi e që vëllëzërit e paditësit janë edhe të të paditurit.

Gjykata nuk ia ka falur besimin deklaratës së dëshmitarit F.R. ,kur ka theksuar se toka ka qenë e familjes së palëve e babës së tyre,por për shkak të shtesave fëmijërore është qitur në emër të gjyshës .Gjyshja jonë nuk e ka shitur këtë tokë,kurse arsyet që gjykata nuk ia ka falur besimin deklaratës në fjalë janë: Kjo deklaratë e këtij dëshmitari është në kundërshtim me deklarinimin e tij në kontratën e datës 11.12.2009 në të cilën kishte theksuar’’ për paluejtshmërit kontestuese se gjyshja e tij ka marrë pjesën e vet të trashëgimis prej paraardhësit të blerësit,e pas shfrytëzimit një kohë të shkurt në vitin 1969 ia ka shitur blerësit për qmimin prej 17500 DM.Kurse ky dëshmitar në deklaratë thekson apo nuk e di sakt dhe në bazë të dijenis time.

Nga deklaratat e dëshmitarit F.R. gjykata ka vërtetuar se i njejtë H.F. ia ka qitur vullnetarisht tokën kontestuese në emrin e tij.

Gjykata pasi vlerësoi provat e administruara e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadin e paditësit H.F. ,si të bazuar ,sepse nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit gjeodet M.M. pjesë

e të cilit janë edhe tri certifikatat pronësore të datës 02.04.2019 u vërtetuar se paluejtshmëria kontestuese në regjistrin kadastrale evidentohet si pronësi e paditësit dhe paditësi ka të drejtë të kërkoj nga i padituri lirimi dhe dorëzimin në posedim të paluejtshmërisë së cekur si në dispozitiv në bazë të nenit 18 në lidhje me nenin 93 të Ligjit për Pronësin dhe të Drejtat tjera Sendore.

Gjykata duke u bazuar në nenin 452.1 i ka detyruar të paditurin që paditësit tia kompenzojnë shpenzimet e procedurës kontestimore si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u bazuar sa i përket lartësisë në tarifen OAK-ut .

Kurse gjykata e ka refuzuar kërkesën e të paditurit në lidhje me shpenzimet e procedurës kontestimore sepse i njejtë e kanë humbur kontestin gjyqësorë.

Vendimi për shtesën e taksës gjyqësore për padi është bazuar në udhëzimin administrativ për unifikimin e taksave gjyqësore.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Gjyqtari : Burim Emërllahu

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nëpërmes të kësaj gjykate.